



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 666 prot.

Tiranë, më 30.04.2024

Lënda: Rekomandim për marrjen e masave për sigurimin e një shërbimi policor gjithëpërfshirës dhe cilësor për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara si dhe për të gjithë personat me aftësi të kufizuar, viktimat të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

### DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT

Bulevardi “*Bajram Curri*”

#### DREJTORISË VENDORE TË POLICISË TIRANË

Rruga “*Sami Frashëri*”

Tiranë

#### DREJTORISË VENDORE TË POLICISË SHKODËR

Rajoni nr.2, Rruga “*Lëvizja e Postribës*”

Shkodër

#### DREJTORISË VENDORE TË POLICISË ELBASAN

Rruga “*Koço Brisku*”

Elbasan

#### DREJTORISË VENDORE TË POLICISË KORÇË

Bulevardi “*Republika*”, Lagjia nr. 1

Korçë

#### DREJTORISË VENDORE TË POLICISË FIER

Lagjia 1 Maj, Rruga “*Koço Plaku*”

Fier

**MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

Rruga e “*Kavajës*”

Tiranë

**FONDACIONIT SË BASHKU**

Rruga “*Dritan Hoxha*”, Blloku Gintash, objekti nr. 2, zyra nr. 14

Tiranë

**FONDACIONIT SHQIPTAR PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË  
KUFIZUAR**

Rruga “*Bogdani*” pall. 15 kat i III (3)

Tiranë

**KOMITETIT SHQIPTAR TË HELSINKIT**

Rruga “*Brigada VIII*”

Tiranë

**QENDRËS PËR NISMA LIGJORE QYTETARE**

Rruga “*Ismail Qemali*”

Tiranë

**QENDRËS TË DREJTAT E NJERIUT NË DEMOKRACI**

Rruga “*Panorama*”, Kompleksi Pajtoni, Ap.B 31 (pranë Hipotekës)

Tiranë

**SHOQATËS “TOGETHER FOR LIFE”**

Rruga “*Barikada VIII*”, pallati jeshil i Teknoprojekt

Tiranë

**QENDRËS PËR TË DREJTAT E GRUAS ROME**

Rruga “*Pandi Dardha*”, Pallati 62, H.2, K.1, Ap.1

Tiranë

**QENDRËS ALEANCA KUNDËR DISKRIMINIMIT LGBT**

Rruga “*Mine Peza*”, private 61, Tiranë

**SHOQATËS UNË, GRUAJA**

Rruga “*Rreshit Çollaku*”

Pogradec

**QENDRËS ALEANCA GJINORE PËR ZHVILLIM**

Rruga “*Abdyl Frashëri*”, P.10/1, ap.3, shk.1

Tiranë

**LINJËS SË KËSHILLIMIT PËR GRA DHE VAJZA**

Rruga “*Muhamet Gjollesha*”, Nd.122, H.4, Ap.8

Tiranë

**ORGANIZATËS “GRUAJA TEK GRUAJA”**

Bulevardi “*Skenderbeu*”

Shkodër

**ORGANIZATËS “FORUMI I GRUAS ELBASAN”**

Lagja “*Luigj Gurakuqi*”, Rruga “*Qemal Stafa*”, Pallati 70, Hyrja 2, Apt.3

Elbasan

**QENDRËS PSIKO-SOCIALE VATRA**

Rruga *Nermin Vlorë Falaski*, Nd.1, H.11, Ap.8

Vlorë

**ORGANIZATËS TË NDRYSHËM & TË BARABARTË**

Rruga “*Fortuzi*”, Godina nr. 24, Hyrja nr.4, Apartamenti. nr.4

Tiranë

**SHOQATËS JONA**

Rruga “*Onhezmi*”, mbi lulishten e Paqes

Sarandë

**SHOQATËS NË DOBI TË GRUAS SHQIPTARE**

Rruga “*Naim Frashëri*”, Nr 6

Tiranë

**RRJETIT TË FUQIZIMIT TË GRAVE SHQIPTARE (AËEN)**

Rruga “*Vaso Pasha*”, P.16, Shk.1/4

Tiranë

**QENDRËS SHQIPTARE PËR POPULLSINË DHE ZHVILLIMIN (ACPD)**

Bulevardi “*Gjergj Fishta*”, P. 26, Hy. 2, Ap. 5, K.P. 1001

Tiranë

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (*në vijim Komisioneri*), është krijuar dhe funksionon në bazë të Ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar (*në vijim LMD*), si institucion i pavarur, i cili siguron mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin.

Bazuar në nenin 32/1/c, të LMD, ku parashikohet: “*Komisioneri ka kompetencë të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji*”, me urdhrin nr.170, datë 07.11.2022, Komisioneri filloi procedurat hetimore për ndjekjen kryesisht të çështjes për identifikimin e problematikave me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuar, të cilët janë viktimat të dhunës në marrëdhëniet familjare, me fokus të veçantë gratë dhe vajzat, në shërbimet e ofruara nga ana e Policisë së Shtetit. Këto procedura hetimore u shtrinë në 5 drejtori vendore të Policisë së Shtetit dhe konkretisht, Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër, Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë.

Kjo procedurë hetimore e ndjekur nga ana e Komisionerit, për të identifikuar problematikat me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuar që janë viktimat të dhunës në marrëdhëniet familjare, me fokus të veçantë gratë dhe vajzat dhe aftësi të kufizuara, në raport me shërbimet e policisë së shtetit, fokusohet në tre drejtime kryesore, të cilat konsistojnë në: Statistikat në lidhje me denoncimet e bëra nga gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara pranë strukturave të policisë së shtetit; Sigurimin e aksesueshmërisë në mjedise, informacion dhe komunikim, në lidhje me ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës, veçanërisht për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuar; Nëse ka procedura dhe/ose udhëzime specifike për trajtimin e rasteve të dhunës ndaj personave me aftësi të kufizuar, e në veçanti ndaj vajzave dhe grave me aftësi të kufizuar;

## **I. PROCEDURA E NDJEKUR NGA KOMISIONERI.**

1. Me shkresën nr.1454/2 prot, datë 17.11.2022, Komisioneri njoftoi për fillimin e procedurave hetimore 5 drejtoritë vendore të Policisë së Shtetit ku u shtrinë procedurat hetimore dhe konkretisht, Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë (*në vijim DVP Tiranë*), Policisë Elbasan (*në vijim DVP Elbasan*), Drejtorinë Vendore të Policisë Fier (*në vijim DVP Fier*), Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë (*në vijim DVP Korçë*), si dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (*në vijim DPPSH*).

Komisioneri kërkoi informacion në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- Statistika mbi rastet e denoncimeve për dhunë në marrëdhënie familjare nga personat me aftësi të kufizuar dhe sa prej këtyre rasteve janë nga gratë dhe vajza me aftësi të kufizuara, për vitet 2020, 2021, 2022.

- Informacion mbi sigurimin e aksesueshmërisë në mjedise, informacion dhe komunikim, në lidhje me ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës, veçanërisht për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara.
  - A ka procedura dhe/ose udhëzime specifike për trajtimin e rasteve të dhunës ndaj personave me aftësi të kufizuara, e në veçanti ndaj vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara?
2. Duke vlerësuar punën dhe kontributin që organizatat e shoqërisë civile kanë në luftën kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në marrëdhëniet familjare, me shkresën nr. 1454/1 prot datë 17.11.2023, Komisioneri kërkoi informacion nga organizata të shoqërisë civile që veprojnë në këtë fushë.

Komisioneri kërkoi informacion në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- Sa është numri i viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare, me aftësi të kufizuara, të cilat janë asistuar nga ana juaj gjatë vitit 2020, 2021, 2022? Sa prej tyre, kanë qenë gra dhe vajza me aftësi të kufizuara?
  - Cilat janë problematikat dhe barrierat kryesore të konstatuara, me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara të cilët janë viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, dhe në veçanti problematikat dhe barrierat për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, për të aksesuar shërbimet e ofruara nga ana e Policisë së Shtetit?
- Bazuar në nenin 33, pika 8, të LMD, ku parashikohet se: *“8. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar”*, për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, Komisioneri në datën 20.02.2023, zhvilloi një seancë dëgjimore publike, ku morën pjesë përfaqësues nga institucionet shtetërore: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoritë Vendore të Policisë Tiranë, Shkodër, Korçë dhe Fier; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile: Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Qendra për të Drejtat e Njeriut në Demokraci, Forumi i Gruas Elbasan, Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, Gruaja te Gruaja, Në Dobi të Gruas Shqiptare, Rrjeti i Fuqizimit të Grave Shqiptare (AWEN).

## II. LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

### Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

## **Neni 18**

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.
2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.
3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.

## **Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut**

### **Neni 14**

#### **Ndalimi i diskriminimit**

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

## **Protokolli 12, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut**

### **Neni 1**

#### **Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit**

1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.
2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.

## **Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje (në vijim Konventa e Stambollit)<sup>1</sup>**

### **Neni 2**

#### **Objekti i Konventës**

---

<sup>1</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 104/2012, datë 8.11.2012 “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”

1. Kjo Konventë zbatohet për të gjitha format e dhunës kundër grave, duke përfshirë dhunën në familje, e cila prek gratë në mënyrë disproporcionale

### **Neni 3**

#### **Përkufizimet**

Për qëllim të kësaj Konvente:

a **“dhunë kundër grave”** kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private;

b **“dhunë në familje”** nënkupton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish bashkëshortëve ose partnerëve ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën;

d) **“Dhunë gjinore kundër grave”** nënkupton dhunën që drejtohet kundër një gruaje për faktin se ajo është grua ose që prek gratë në mënyrë disproporcionale;

### **Neni 4**

#### **Të drejtat themelore, barazia dhe mosdiskriminimi**

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative dhe masa të tjera për të promovuar dhe mbrojtur të drejtën për çdokënd, veçanërisht gratë, për të jetuar pa dhunë në sferën publike, si dhe në atë private.

2. Palët dënojnë të gjitha format e diskriminimit kundër grave dhe marrin pa vonesë masat legjislative dhe masa të tjera të nevojshme për t'i parandaluar, veçanërisht me anë të:

- shprehjes së parimit të barazisë midis burrave dhe grave në kushtetutat e tyre kombëtare ose në ndonjë legjislacion tjetër përkatës, duke garantuar realizimin praktik të këtij parimi;
- ndalimit të diskriminimit kundër grave, veçanërisht nëpërmjet ushtrimit të sanksioneve, sipas rastit;
- shfuqizimit të ligjeve dhe praktikave që diskriminojnë gratë.

3. Zbatimi i dispozitave të kësaj Konvente nga palët, veçanërisht masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, sigurohen pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, gjuhe, feje, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjine kombëtare ose sociale, përkatësie në një pakicë kombëtare, pasurie, lindjeje, orientimi seksual, identiteti gjinor, moshe, gjendjeje shëndetësore, aftësie të kufizuar, statusi civil, statusi emigranti ose refugjati ose statusi tjetër.

4. Masat e veçanta që janë të nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen e grave nga dhuna gjinore nuk konsiderohen diskriminim sipas kushteve të kësaj Konvente.

## **Neni 11**

### **Mbledhja dhe kërkimi i të dhënave**

1. Për qëllim të zbatimit të kësaj Konvente, palët marrin përsipër:

a) të mbledhin të dhëna përkatëse të zërthyer statistike, në intervale të rregullta kohore, në lidhje me rastet e të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente;

### **Konventa e OKB-së “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”<sup>2</sup>.**

#### **Neni 1**

Për qëllimet e kësaj Konvente shprehja "diskriminimi ndaj grave" nënkupton çdo dallim, përjashtim ose kufizim që bëhet mbi bazën e seksit, e që ka për pasojë ose për qëllim të komprometojë ose të asgjësojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, pavarësisht nga gjendja e tyre martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër.

### **Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar”<sup>3</sup>**

#### **Neni 1**

##### **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj konvente është të promovojë, të mbrojë dhe të sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektimin e dinjitetit të tyre të lindur.

Personat me aftësi të kufizuara përfshijnë ata që kanë dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat, në ndërveprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.

#### **Neni 2**

##### **Përkufizimet**

Për qëllimet e kësaj konvente:

---

<sup>2</sup> Ratifikuar me Ligjin nr. 7767, datë 9.11.1993.

<sup>3</sup> Ratifikuar me Ligjin nr.108/2012.



“Komunikim” përfshin gjuhët, shfaqje teksti, *Braille*, komunikimin me prekje, printim me gërmë të madhe, multimedian digjitale, si dhe gjuhë të qartë, të dëgjuar dhe të shkruar, lexues dhe mënyra, mjete dhe forma komunikimi shtesë apo alternative, përfshirë informacionin digjital dhe teknologjinë e komunikimit.

“Gjuha” përfshin gjuhën e folur dhe gjuhën e shenjave, si dhe forma të tjera të gjuhës jo të folur.

“Diskriminim me bazë aftësinë e kufizuar” do të thotë që çdo dallim, përjashtim apo kufizim me bazë aftësinë e kufizuar, që ka si qëllim ose ndikon në dëmtimin apo anulimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit, mbi baza të barabarta me të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile apo në ndonjë fushë tjetër. Ky përkufizim përfshin të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë dhe mohimin e akomodimit të arsyeshëm.

“Akomodim i arsyeshëm” do të thotë modifikim dhe rregullim i nevojshëm dhe i përshtatshëm që nuk krijon një barrë disproporcionale, që është i nevojshëm në raste të veçanta, për t’u siguruar personave me aftësi të kufizuara gëzimin dhe ushtrimin e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut me baza të barabarta me të tjerët.

“Projektim universal” do të thotë projektim i mallrave, mjedisit, programeve dhe shërbimeve për t’i bërë të përdorshme për të gjithë njerëzit, në masën më të madhe të mundshme, pa pasur nevojë për përshtatje apo projektim të veçantë. Projektimi universal nuk duhet të përjashtojë pajisjet ndihmese për grupe të veçanta të personave me aftësi të kufizuara, kur është e nevojshme.

## **Neni 5**

### **Barazia dhe mosdiskriminimi**

1. Shtetet palë pranojnë se të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe sipas ligjit dhe se kanë të drejtë pa asnjë diskriminim për mbrojtje të barabartë dhe përfitim të barabartë nga ligji.
2. Shtetet palë duhet të ndalojnë çdo lloj diskriminimi me bazë aftësinë e kufizuar dhe t’u garantojnë personave me aftësi të kufizuara mbrojtje ligjore të barabartë dhe efektive ndaj çdo lloj diskriminimi në të gjitha situatat.
3. Me qëllim që të promovohet barazia dhe të eliminohet diskriminimi, shtetet palë duhet të ndërmarrin të gjithë hapat e duhur për të siguruar që është arritur akomodimi i arsyeshëm.
4. Masat specifike të cilat janë të nevojshme për të përsheptuar apo arritur *de facto* barazinë e personave me aftësi të kufizuara nuk duhet të konsiderohen diskriminim sipas termave të kësaj konvente.

## **Neni 6**

### **Gratë me aftësi të kufizuara**

1. Shtetet palë pranojnë se gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara i nënshtrohen një diskriminimi shumëformësh, dhe për këtë do të marrin masa për të siguruar se ato gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.
2. Shtetet palë duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar zhvillimin, përparimin dhe fuqizimin e plotë të grave, me qëllim që t'u garantohet atyre ushtrimi dhe gëzimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të përcaktuara në këtë konventë.

## **Neni 9**

### **Heqja e barrierave**

1. Me qëllim që të bëhet e mundur që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, shtetet palë duhet të marrin masa për të siguruar mundësimin për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në ambientet fizike, transport, informacion dhe komunikim, përfshirë dhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në mjete apo shërbime të tjera të hapura apo të siguruara për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Këto masa, të cilat duhet të përfshijnë identifikimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave për mundësimin, zbatohen ndër të tjera për:
  - a) ndërtesa, rrugë, transport dhe mjete të tjera në ambiente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, shërbime mjekësore apo vendet e punës;
  - b) informacion, komunikim dhe shërbime të tjera, përfshirë shërbimet elektronike dhe shërbimet e emergjencës.

## **Neni 13**

### **Mundësimi i drejtësisë**

1. Shtetet palë duhet të sigurojnë akses efektiv në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara në baza të barabarta me të tjerët, përfshirë nëpërmjet sigurimit të mundësive të përshtatshme procedurale dhe të moshës, me qëllim që të lehtësohet roli i tyre efektiv si pjesëmarrës direkt dhe jodirekt, përfshirë dhe si dëshmitarë, në të gjitha gjykimet, përfshirë hetimet dhe stadi të tjera paraprake.
2. Me qëllim që të jepet ndihmesë në sigurimin e mundësimin efektiv në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara, shtetet palë duhet të promovojnë trajnime për ata persona që punojnë në fushën e administrimit të drejtësisë, përfshirë policinë dhe personelin e burgut.

## **Neni 16**

### **Lirimi nga shfrytëzimi, dhuna dhe abuzimi**

1. Shtetet palë duhet të marrin masat e duhura legislative, administrative, shoqërore, arsimore dhe masa të tjera për të mbrojtur personat me aftësi të kufizuara, si brenda familjes dhe jashtë saj, nga të gjitha format e shfrytëzimit, dhunës dhe abuzimit, përfshirë aspektet me bazë gjinore.
2. Shtetet palë duhet të marrin gjithashtu të gjitha masat e duhura për të parandaluar të gjitha format e shfrytëzimit, dhunës dhe abuzimit, duke siguruar, ndër të tjera, format e duhura të asistencës në bazë të gjinisë dhe moshës dhe mbështetje për personat me aftësi të kufizuara, familjeve të tyre dhe punonjësve të kujdesit, përfshirë nëpërmjet sigurimit të informacionit dhe edukimit se si të shmangen, njihen apo raportohen rastet e shfrytëzimit, dhunës apo abuzimit. Shtetet palë duhet të sigurojnë se shërbimet e mbrojtjes tregojnë ndjeshmëri ndaj moshës, gjinisë dhe aftësisë së kufizuar.
3. Me qëllim që të parandalohen të gjitha format e shfrytëzimit, dhunës dhe abuzimit, shtetet palë duhet të sigurojnë që të gjitha mjetet dhe programet e projektuara për t'u shërbyer personave me aftësi të kufizuara të monitorohen në mënyrë efektive nga autoritete të pavarura.
4. Shtetet palë duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të promovuar shërimin dhe rehabilitimin fizik, njohës dhe psikologjik dhe riintegrimin shoqëror të personave me aftësi të kufizuara, të cilët janë viktimat të çdo lloji forme shfrytëzimi, dhune apo abuzimi, përfshirë nëpërmjet sigurimit të shërbimeve mbrojtëse. Një shërim dhe riintegrim i tillë duhet të ndodhë në një ambient që mbështet shëndetin, mirëqenien, vetërespektin, dinjitetin dhe autonominë e personit dhe merr parasysh nevojat specifike gjinore dhe të moshës.
5. Shtetet palë duhet të sigurojnë legjislacionin dhe politika efektive, përfshirë legjislacionin dhe politikat në lidhje me gratë dhe fëmijët, për të siguruar se janë identifikuar, hetuar dhe kur duhet, janë ndjekur ligjërisht rastet e shfrytëzimit, dhunës dhe abuzimit ndaj personave me aftësi të kufizuara.

## **Neni 31**

### **Statistikat dhe mbledhja e të dhënave**

1. Shtetet palë marrin përsipër të mbledhin informacionin e duhur, përfshirë të dhëna statistikore dhe kërkimore, për të mundur që këto shtete të formulojnë dhe zbatojnë politika që do i japin fuqi kësaj konvente.

.....

2. Informacioni i mbledhur në përputhje me këtë nen mund të shpërndahet sipas rastit dhe përdoret për të ndihmuar për të vlerësuar zbatimin e detyrimeve të shteteve palë në këtë konventë, dhe të identifikojë dhe adresojë barrierat që ndeshen nga personat me aftësi të kufizuara gjatë ushtrimit të të drejtave të tyre.

3. Shtetet palë marrin përgjegjësinë për përhapjen e këtyre statistikave dhe sigurojnë që ato të jenë të mundshme për personat me aftësi të kufizuara dhe për të tjerët.

**Ligji Nr.93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”**

**Neni 1**

**Objekti**

Objekt i këtij ligji janë:

- a) përcaktimi i të drejtave thelbësore që lidhen me përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, me qëllim garantimin e mundësive të barabarta për të gjithë këta persona në kushte të barabarta me të tjerët.

**Neni 3**

**Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Aksesueshmëri” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve.
3. “Pengesat” nënkupton:
  - a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore;
  - b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t’u lexuar dhe për t’u kuptuar;
  - c) pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike;
  - ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika.

**Neni 17**

**Të dhënat dhe statistikat**

2. Insitucionet shtetërore, qendrore dhe vendore, mbledhin të dhëna statistikore për aftësinë e kufizuar sipas fushave ku ato operojnë. Llojshmëria e periodiciteti i mbledhjes së të dhënave dhe mënyra e raportimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

**Ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (në vijim LMD)**

**Neni 1**

**Objekti**

Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike,

gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

## **Neni 2**

### **Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për:

- a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

## **Neni 3**

### **Përkufizimet**

1. “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

3. “Diskriminim ndërsektorial” është ajo formë diskriminimi në të cilën disa shkaqe veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëra-tjetrën në të njëjtën kohë, në mënyrë të tillë që ato të jenë të pandashme dhe të prodhojnë forma të veçanta të diskriminimit.

5. “Diskriminim i shumëfishtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në dy ose më shumë shkaqe që veprojnë veçmas.

9. “Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme” është ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme, që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore, të njohura në kuadrin ligjor kombëtar, për personat me aftësi të kufizuar, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.

## **Neni 3/1**

## **Format e rënda të diskriminimit**

Çdo sjellje diskriminuese që është motivuar nga më shumë se një shkak, kur është kryer më shumë se një herë, kur ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore, ose kur ka sjellë pasoja veçanërisht të dëmshme për viktimën përbën formë të rëndë të diskriminimit.

### **Neni 7**

#### **Mbrojtja nga diskriminimi**

1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.
2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.
3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

**Ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar (në vijim ligji nr.9669/2006)<sup>4</sup>**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim:

1. Parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore dhe të masave të tjera të nevojshme.
2. Garantimin e mbrojtjes me masa ligjore dhe me masa të tjera të nevojshme të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat e dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë grave, vajzave, fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara, subjekt i këtij ligji, sipas nenit 3 të tij.

### **Neni 3/1**

#### **Legjislacioni i zbatueshëm**

---

<sup>4</sup> Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008; nr. 10 329, datë 30.9.2010; nr. 47/2018, datë 23.7.2018; nr. 125/2020, datë 15.10.2020.

1. Ky ligj bazohet në parimet e sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, Konventën e Këshillit të Evropës, “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” dhe në aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

2. Zbatimi i dispozitave të këtij ligji, veçanërisht masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, sigurohen pa diskriminim, për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

## **Neni 5**

### **Autoritetet përgjegjëse**

1. Autoriteti kryesor përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje.

2. Autoritete të tjera përgjegjëse të linjës janë:

.....

b) ministria përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike;

## **Neni 6**

### **Detyrat e autoritetit kryesor përgjegjës**

Autoriteti kryesor përgjegjës ka këto detyra:

.....

ç) organizimin e trajnimeve për parandalimin dhe trajtimin e çështjeve të dhunës në familje për punonjësit e shërbimeve sociale, të cilët ofrojnë shërbime, pranë çdo njësie të vetëqeverisjes vendore, strukturat e Policisë së Shtetit,.....

.....

d) bashkërendimin e punës për mbajtjen dhe mbledhjen e të dhënave statistikore, për rastet e dhunës në familje, duke përfshirë dhe analizimin, publikimin dhe raportimin vjetor pranë komisionit përgjegjës parlamentar/nënkomisionin për çështjet e barazisë gjinore dhe të parandalimit të dhunës ndaj grave.

.....

h) hartimin, në bashkëpunim edhe me autoritetet e tjera të linjës, të procedurave, standardeve ose protokolleve, lidhur me vlerësimin e riskut dhe planet e ndërhyrjes në rastet e dhunës në familje, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre;

## **Neni 7**

### **Detyrat e autoriteteve përgjegjëse të linjës**

1. Ministria përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike ka këto detyra:

a) krijimin e sektorëve të veçantë për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje pranë drejtorive të policisë;

b) trajnimin e punonjësve të Policisë së Shtetit, që do të trajtojnë rastet e dhunës në familje, me qëllim rritjen e kapaciteteve në identifikimin e rasteve të dhunës në familje, vlerësimin e riskut dhe intervistimin e viktimës e të dhunuesit dhe me aspekte të tjera të lidhura me zbatimin e detyrimeve të parashikuara nga ky ligj;

b/1) miratimin, me udhëzim të përbashkët me ministrinë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje, të modelit dhe të procedurave për vlerësimin e riskut për rastet e dhunës në familje.

## **Ligji Nr. 108/2014 “Për policinë e shtetit”, i ndryshuar.**

### **Neni 2**

#### **Misioni i Policisë së Shtetit**

Policia e Shtetit ka për mision ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.

### **Neni 5**

#### **Parimet e veprimtarisë**

Parimet bazë, në bazë të të cilave udhëhiqet Policia e Shtetit në veprimtarinë e saj, janë:

b) mosdiskriminimi;

c) respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;

**Vendimi nr. 327, datë 2.06.2021 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës” (në vijim VKM nr.327/2021)**

## **I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Ky vendim rregullon procedurat standarde bazë për bashkërendimin e punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për parandalimin e dhunës në familje, për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të të gjitha formave të dhunës në familje, duke garantuar të drejtat e



njeriut e promovuar barazinë gjinore, si edhe eliminuar të gjitha format e diskriminimit ndaj grave.

**Vendimi i Këshillti të Ministrave Nr.1503, datë 19.11.2008 “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”**

## **PJESA I**

**Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike**

### **Kreu I**

**Të përgjithshme**

#### **Neni 1**

**Objekti, qëllimi dhe fusha e aplikimit**

1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave teknike për eliminimin e pengesave që përcaktohen si “barriera arkitektonike”.
2. Kjo rregullore ka për qëllim zbatimin e rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike.
3. Fusha e aplikimit të saj shtrihet në:
  - të gjitha objektet publike të reja të ndërtuara me fondet e buxhetit të shtetit apo private si dhe në objektet private, që ndërtohen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;
  - godinat dhe hapësirat publike, ndërtimet e reja me karakter të përkohshëm, ose në ato ekzistuese nëse do t’i nënshtrohen rikonstruksionit;
  - ndërtesat dhe hapësirat publike që i nënshtrohen çfarëdolloj ndërhyrjeje ndërtimi që ka të bëjë me heqjen e kufizimit të mundësisë së pamjes dhe fushëpamjes, që të paktën, qoftë edhe pjesërisht, është pjesë e ndërhyrjes;
  - ndërtesat dhe hapësirat publike që janë, tërësisht ose pjesërisht, objekt i ndryshimit të destinacionit nëse do të jetë në përdorim publik, si edhe për shërbime të veçanta për përdorim publik.

#### **Neni 2**

**Përshtatja e objekteve ekzistuese**

1. Në ndërtesat dhe hapësirat publike ekzistuese, edhe pse nuk janë objekt ristrukturimi ose riorganizimi funksional, duhet të evidentohen dhe te llogariten të gjitha mundësitë për përshtatje, të cilat mund të përmirësojnë shfrytëzimin në bazë të kërkesave që janë në këtë rregullore. ....

.....

4. Nuk mund të ofrohen kontribute ose lehtësime nga ana e shtetit dhe e enteve të tjera publike për realizimin e punimeve publike ose të shërbimeve publike në kundërshtim me këto rregulla dhe standarde.

**Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”**

**KREU I  
RREGULLIME TË PËRGJITHSHME**

1. Ky vendim përcakton masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjahen pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara.

4. Ky vendim e shtrin zbatimin mbi:

b) të gjitha ndërtimet e strukturat ndërtimore të reja dhe ekzistuese, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, kryesisht objektet e shëndetit publik, banesat dhe objektet rezidenciale, shkollat dhe institucionet shkencore, objektet kulturore, objektet e kultit, qendrat tregtare, institucionet administrative e të shërbimit publik, ndërmarrjet e qendrat e punës, në mjediset e të cilave ofrohen shërbime publike, parqet, sheshet e rrugët;

16. Ndalohet dhënia e financimeve ose mbështetja financiare nga ana e shtetit apo enteve publike dhe jopublike/donatorëve për ndërtimin e një vepre, me qëllim ofrimin e shërbimit publik, nëse objekti nuk përmbush kërkesat e parashikuara në këtë vendim.

**III. STANDARTET DHE DETYRIMET PËR ZBATIM**

Sipas Censusit të vitit 2011, 6,2 për qind e popullsisë në moshë madhore në Shqipëri<sup>5</sup> - ose 137 435 persona, kanë një lloj aftësie e kufizuar, nga të cilët 75 239 janë gra dhe vajza me aftësi të kufizuar dhe 62.196 janë burra dhe djemtë me aftësi të kufizuar. Të rinjtë regjistrojnë nivele të ulëta të aftësisë së kufizuar, nën 3% për të dyja gjinitë. Në anën tjetër, grupi i moshës 50 - 64 vjeç shfaqin incidencë më të lartë të aftësisë së kufizuar: përkatësisht 6% për burrat dhe 8% për gratë. Për moshat mbi 65 vjeç, nivelet e aftësisë së kufizuar janë 20 % për burrat dhe 25 % për gratë.

Sistemi ndërkombëtar për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut ka marrë përsipër sfidën e tejkalimit të këtij realiteti, nëpërmjet Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, me vendosjen e modelit të të drejtave të njeriut, bazuar në modelin bio-psiko-social të personave me aftësi të kufizuara, i cili vë theksin në

---

<sup>5</sup> 2 Popullsia e moshës 15 vjeç e lart.

ndërveprimin me barrierat që pengojnë ose vështirësojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri.

Shqipëria e ka ratifikuar Konventën e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara” që në vitin 2012<sup>6</sup>. Për rrjedhojë, shteti ka si detyrim dhe prioritet kryesor eliminimin e barrierave dhe krijimin e kushteve për mundësi të barabarta për personat me aftësi të kufizuara. Në nenin 16, Konventa, njeh të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të qenë të mbrojtur nga shfrytëzimi, dhuna dhe abuzimi, ndërsa në nenin 13, i cili parashikon të drejtën për të patur akses në drejtësi, vendos detyrimin ndaj shteteve për marrjen e masave për të siguruar akses efektiv në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara në baza të barabarta me të tjerët. Neni 6, i KDPAK, pranon se, gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara janë gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara i nënshtrohen diskriminimit të shumëfishtë dhe për këtë shtetet angazhohen të marrin masa për të siguruar se ato gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Aksesueshmëria ose e thënë ndryshe heqja e pengesave/barrierave, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë. Për rrjedhojë, aksesueshmëria është ngushtësisht e lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuara. Aksesueshmëria duhet të sigurohet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara dhe duke mbajtur parasysh diferencat e tyre. Për rëndësinë që aksesueshmëria paraqet, parashikohet nga KDPAK si një e drejtë më vete në nenin 9, por edhe si një nga parimet themelore që përshkon të gjithë Konventën, sipas nenit 3.

Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, shprehet në Komentin e Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria” se, nuk mund të ketë akses efektiv në drejtësi nëse ndërtesat në të cilat ndodhen agjencitë e zbatimit të ligjit dhe gjyqësori nuk janë fizikisht të aksesueshme, ose nëse shërbimet, informacioni dhe komunikimi që ato ofrojnë nuk janë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara (neni 13). Shtëpitë e sigurta, shërbimet mbështetëse dhe procedurat duhet të jenë të gjitha të aksesueshme në mënyrë që të ofrojnë mbrojtje efektive dhe kuptimplote nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi për personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht gratë dhe fëmijët (neni 16)”. Po këtu, Komiteti sqaron se, aksesueshmëria lidhet me grupet, ndërsa përshtatja e arsyeshme ka të bëjë me individin. Kjo do të thotë që detyrimi për të siguruar aksesueshmërinë është një detyrë *ex ante*. Për këtë arsye, subjektet, kanë për detyrë të sigurojnë aksesueshmërinë para se të marrin kërkesa për të hyrë në një vend ose për të përdorur/marrë një shërbim, nga ana e individit. Detyrimi për të siguruar aksesueshmërinë është i pakushtëzuar, kjo do të thotë që subjekti i

---

<sup>6</sup> Ratifikuar me Ligjin nr.108/2012.

detyruar për sigurimin e aksesueshmërisë nuk mund të justifikojë mosveprimin për t'a siguruar atë, duke iu referuar barrës për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Në mënyrë të kundërt, detyrimi për të siguruar përshtatjen e arsyeshme, ekziston vetëm nëse zbatimi nuk përbën ndonjë barrë të tepruar për subjektin.<sup>7</sup> Detyra për të ofruar përshtatjen e arsyeshme është një detyrë *ex nunc*, që do të thotë se është e detyrueshme që nga momenti kur një individ me dëmtim ka nevojë për të në një situatë të caktuar. Këtu, standardet e aksesueshmërisë mund të jenë një tregues, por mund të mos merren si urdhëruese.

Në vërejtjet përmbyllëse mbi raportin fillestar të Shqipërisë të vitit 2019, Komiteti mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara rekomandoi përfshirjen e një perspektive të aftësisë së kufizuar në të gjitha politikat dhe programet e barazisë gjinore. Ndërsa në kuadër të nenit 16, "Liria nga shfrytëzimi, dhuna dhe abuzimi" rekomandon që, ligji për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare të zbatohet duke përfshirë perspektivën e aftësisë së kufizuar dhe adresimin e risqeve të veçanta të dhunës me bazë gjinore dhe pengesat për mbrojtje me të cilat përballen gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara.

Neni 31 i kësaj Konvente kërkon nga çdo shtet palë i saj të mbledhë të dhëna statistikore për të bërë të mundur që shteti të hartojë dhe zbatojë politika që do i japin efekt kësaj Konvente. Në Komentin e Përgjithshëm Nr.6 (2018) për barazinë dhe mosdiskriminimit, Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, sqaron se, mbledhja dhe analiza e të dhënave janë masa thelbësore për monitorimin e politikave dhe ligjeve kundër diskriminimit. Shtetet palë duhet të mbledhin dhe analizojnë të dhëna, të cilat duhet të ndahen në bazë të aftësisë së kufizuar dhe kategorive ndërsektoriale. Të dhënat e mbledhura duhet të ofrojnë informacion për të gjitha format e diskriminimit. Të dhënat e mbledhura duhet të jenë të gjera dhe të mbulojnë statistika, narrativa dhe forma të tjera të dhënash, të tilla si tregues për të vlerësuar zbatimin dhe monitoruar progresin dhe efektivitetin e nismave dhe politikave të reja ose në vazhdim. Treguesit që përfshijnë aftësinë e kufizuar duhet të zhvillohen dhe përdoren në një mënyrë në përputhje me Axtendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Hartimi, mbledhja dhe analiza e të dhënave duhet të jetë pjesëmarrëse, d.m.th., të ndërmerret në konsultim të ngushtë dhe kuptimplotë me organizatat përfaqësuese të personave me aftësi të kufizuara, përfshirë fëmijët.

Në lidhje me nenin 31 "Statistikat dhe mbledhja e të dhënave", në vërejtjet përmbyllëse mbi raportin fillestar të Shqipërisë të vitit 2019, Komiteti mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara rekomandoi mbledhjen e të dhënave mbi dhunën ndaj personave me aftësi të kufizuara.

---

<sup>7</sup> Komenti i Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 "Aksesueshmëria", miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, paragrafi 25

Në Rekomandimin të Përgjithshëm nr. 19 (1992) “Mbi dhunën ndaj grave”, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), sqaron se, diskriminimi ndaj grave, siç përcaktohet në nenin 1 të Konventës, përfshin dhunën me bazë gjinore, që është *dhuna që është drejtuar kundër një gruaje për shkak se ajo është grua ose që prek gratë në mënyrë disproporcionale dhe se përbën shkelje të të drejtave të tyre njerëzore.* Me Rezolutën 48/104, miratuar në datën 20 dhjetor 1993, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, ka miratuar Deklaratën për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, duke njohur nevojën urgjente për zbatimin universal për gratë të të drejtave dhe parimeve në lidhje me barazinë, sigurinë, lirinë, integritetin dhe dinjitetin e të gjitha qenieve njerëzore. Në vitin 1995, Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim, identifikuan çrrënjosjen e dhunës ndaj grave si një objektiv strategjik, midis kërkesave të tjera për arritjen e barazisë gjinore.

Rekomandimi nr.35 mbi dhunën me bazë gjinore kundër grave, i CEDAW, i cili rishikon Rekomandimin e Përgjithshëm Nr.19 të po këtij Komiteti, parashtrohet rekomandime të rëndësishme në lidhje me mbledhjen e të dhënave. Rekomandimi kërkon ngritjen e një sistemi që mbledh në mënyrë të rregullt, analizon dhe publikon të dhëna mbi një sërë aspektesh që lidhen me dhunën me bazë gjinore kundër grave, duke theksuar ndër të tjera që të gjitha të dhënat duhet të jenë të disagreguara edhe në lidhje me format ndërsektoriale të diskriminimit kundër grave. Mbajtja e të dhënave do të mundësojë identifikimin e dështimeve në mbrojtje dhe do të shërbejë për të përmirësuar masat parandaluese.

Komiteti CEDAW në vërejtjet e tij përmblylëse për Shqipërinë në 2016, rekomandon, miratimin e ligjeve, politikave dhe programeve të trëtuara për të garantuar të drejta të barabartë për gratë që i përkasin grupeve të disavantazuara dhe të marginalizuara, ku përfshihen edhe gratë me aftësi të kufizuara, në përputhje me kriteret e vendosura në Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. CEDAW, kërkon nga Shqipëria që në raportin e ardhshëm periodik, të përfshijë të dhëna në lidhje me gëzimin nga këto gra të të drejtave të garantuara sipas Konventës CEDAW.

Me ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” shteti shqiptar ka marrë përsipër detyrime të rëndësishme në lidhje me parandalimin dhe luftimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Konventa e Stambollit në nenin 11 të saj “Mbledhja dhe kërkimi i të dhënave” ngarkon në mënyrë të drejtëpërdrejtë shtetet palë me detyrimin për mbledhjen e të dhënave të zberthyer dhe të mbledhura në intervale të rregullta kohore, në lidhje me të gjitha format e dhunës ndaj grave të mbuluara nga objekti i kësaj konvente.

Në Raportin për Shqipërinë të vitit 2017, në kuadër të marrjes së masave për të adresuar

diskriminimin ndërsektorial, GREVIO ka rekomanduar autoritetet shqiptare që të: - shtojnë te mbledhja e të dhënave disa tregues specifikë që lidhen me grupet vulnerabël të grave dhe vajzave;- integrojnë perspektivën e grupeve të tilla në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave; - integrojnë parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave në programet të cilat janë përshtatur për nevojat specifike të grupeve të tilla.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka diskutuar në çështjet e shqyrtuara prej saj ndër lidhjen ndërmjet diskriminimit dhe dhunës ndaj grave dhe është shprehur se dhuna me bazë gjinore përbën një formë diskriminimi sepse kryesisht prek gratë dhe gratë nuk mbroheshin nga ligji në baza të barabarta me burrat.

Ligji Nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, kërkon që të gjitha masat mbrojtëse ligjore, të parashikuara nga ky ligj, të garantohen duke u kushtuar vëmendje të veçantë ndër të tjera, grave, vajzave dhe personave me aftësi të kufizuara, subjekt i këtij ligji. Në germën “f”, të nenit 3, të këtij ligji, tek pjesëtarët e familjes, parashikohet edhe kujdestari dhe personi që ndodhet në kujdesin e tij gjatë kohës që vazhdon kujdestaria, sipas përcaktimeve të kujdestarisë mbi të miturit dhe kujdestarisë për personat me aftësi të kufizuar dhe personit që i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar sipas dispozitave të Kodit të Familjes.

Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar si dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, parashikojnë një sërë veprimesh dhe shërbimesh që Policia e Shtetit mbart detyrimin për të ofruar për viktimat e dhunës në familje dhe gjunës me bazë gjinore.

#### **IV. PROBLEMATIKAT E IDENTIFIKUARA ME TË CILAT PËRBALLEN PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR, TË CILËT JANË VIKTIMA TË DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE, ME FOKUS TË VEÇANTË GRATË DHE VAJZAT, NË SHËRBIMET E OFRUARA NGA ANA E POLICISË SË SHTETIT.**

##### **- Statistikat në lidhje me dhunën ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara.**

Bazuar në informacionin e vendosur në dispozicion nga DPPSH dhe DVP ku është shtrirë hetimi administrativ, rezulton se, sistemi i statistikave në Policinë e Shtetit bazohet në Udhëzimin e Ministrit të Punëve të Brendshme Nr.274, datë 1.09.2014 “Për statistikave të kriminalitetit” dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.1531, datë 24.10.2014 “Për hartimin e statistikave të kriminalitetit”. Bazuar në këto dy akte rregulluese,

rezultojn se, për rastet e denoncimeve të dhunës në marrëdhëniet familjare, Policia e Shtetit, nuk gjeneron të dhëna me statusin “Person me aftësi të kufizuar”. Për sa i përket të dhënave në lidhje me dhunën në familje, Policia e Shtetit administron të dhëna për viktimën e dhunës në familje, sipas lidhjes familjare, moshës, gjinisë, vendbanimit, por nuk administron të dhëna nëse viktimja e dhunës në familje është person me aftësi të kufizuar.

Në përgjigje të kërkesës për informacion të Komisionerit, pavarësisht se nuk mbahen statistika zyrtare në lidhje me rastet e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje ku viktimja janë personat me aftësi të kufizuar, DVP Tiranë dhe DVP Elbasan kanë identifikuar dhe kanë vendosën në dispozicion të dhënat e mëposhtme:

DVP Tiranë, raportoi se në këtë drejtori është evidentuar dhe referuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, 1 denoncim për veprën penale “Dhunë në familje”, ku e dëmtuara ka qenë me aftësi të kufizuara, ndërsa urdhri i mbrojtjes është plotësuar ndaj ish të dashurit.

Në Komisarjatin e Policisë Kavajë janë evidentuar dhe referuar pranë organit të prokurorisë 5 raste, nga të cilat, 4 raste janë përfshirë personat me aftësi të kufizuar për veprën penale “Dhunë në familje”, parashikuar nga neni 130/a të Kodit Penal, në 1 rast autor është djali ndaj prindërve, 1 rast janë bashkëshortët ndaj njëri tjetrit dhe vëllai ndaj vëllait dhe 1 rast autor ka qenë bashkëshorti ndaj bashkëshortes, ndërsa 1 rast për veprën penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale në gjini ose në kujdestari”, parashikuar nga neni 106 i Kodit Penal, me të dëmtuar motër dhe autor vëllai me probleme të shëndetit mendor. Rasti është dërguar për trajtim pranë qendrës për menaxhimin e krizës në rastet e dhunës seksuale “Lilium”. Për 5 rastet, autorët e veprave penale ku autorët janë me probleme të shëndetit mendor, gjykata kompetente ka marrë masa sigurimi personal të karakterit mjekësor.

DVP Elbasan, raporton se nga Komisarjati i Policisë Elbasan janë evidentuar dhe raportuar pranë organit të prokurorisë, 5 raste ku janë përfshirë persona me aftësi të kufizuar, për veprën penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, nga të cilat: në 2 raste të dëmtuarat nga dhuna në familje kanë qenë bashkëjetueset, të cilat kanë probleme të shëndetit mendor; në 1 rast i dëmtuar ka qenë bashkëshorti i cili ka status invalidi për kategorinë i verbër; në 2 raste të tjera të dhunës në familje autorët e veprës penale janë persona me probleme të shëndetit mendor, ku respektivisht në 1 rast është vajza autore dhe e dëmtuar nëna; në 1 rast autor është bashkëshorti dhe e dëmtuar bashkëshortja. Në vijim të procedurave, të dy shtetasit dhunues me probleme të shëndetit mendor janë shtruar pranë spitalit psikiatrik Elbasan për tu trajtuar nga ana mjekësore.

DVP Elbasan raporton se janë plotësuar 3 kërkesë padi për lëshimin e urdhërit të mbrojtjes, për 3 shtetase, ku në 1 rast e dëmtuar është motra, 1 rast bashkëshortja dhe 1 rast bashkëjetuesja. Të treja këto shtetase janë me probleme të shëndetit mendor. Në Komisarjatin

e tjera në qarkun e Elbasanit nuk ka patur raste të evidentuara për këtë kategori personash gjatë viteve 2020, 2021, 2022.

DVP Elbasan sqaron se, në formularët e statistikave nuk ka zëra të veçantë të dedikuar për personat me aftësi të kufizuar, por pasi ato evidentohen referohen pranë Koordinatorëve Vendorë të Dhunës në Familje pranë Bashkive përkatëse.

Në bazë të informacionit të vendosur në dispozicion nga organizatat e shoqërisë civile, rezulton se nuk është praktikë e konsoliduar mbajtja e të dhënave për personat me aftësi të kufizuar që janë viktimat e dhunës në marrëdhënie familjare ose viktimat e kësaj dhune që janë gra dhe vajza me aftësi të kufizuar. Megjithatë, rezultoi se ka organizata të shoqërisë civile të cilat e kanë praktikë mbajtjen e statistikave për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në marrëdhëniet familjare që janë me aftësi të kufizuar.

Shoqata “Forumi i Gruas Elbasan” (FGE), e cila ushtron veprimtarinë e saj në Qarkun e Elbasanit, raportoi se: për vitin 2020 ka asistuar në total 50 gra/vajza me aftësi të kufizuar; për vitin 2021 ka asistuar 58 gra/vajza me aftësi të kufizuar; për vitin 2022 ka asistuar 47 gra/vajza me aftësi të kufizuar. Gjatë seancës dëgjimore, FGE, theksoi, se pavarësisht këtyre shifrave, dhuna ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara është më e madhe dhe mbetet e paraportuar për shkak se nuk ka infrastrukturë të përshtatshme.

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, (ADRF) raportoi gjatë seancës dëgjimore se, në bazë të monitorimit të zhvilluar për një periudhë 16 mujore, që përfshin periudhën shtator 2021-2022, në 5 bashki, janë raportuar 302 raste të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuar që kanë denoncuar dhunën pranë policisë. Gjatë seancës dëgjimore ADRF, theksoi se, ka një boshllëk midis dhunës reale që ndodh ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuar dhe asaj që raportohet. Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara nuk kanë informacion se çfarë është dhuna, ku duhet të drejtohen dhe mungojnë shërbimet mbështetëse të aksesueshme. Vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuar janë të varura nga familja. Ato rikthehen në shtëpi, pasi jeta e tyre është e lidhur me familjen. Është e vështirë që të bindësh gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuar që të denoncojnë dhunën, pasi mungon zinxhiri i shërbimeve mbështetëse dhe shërbimet për një jetesë të pavarur.

Organizata të tjera të shoqërisë civile si Rrjeti i Fuqizimit të Gruas (AWEN) dhe Qendra për të Drejtat e Njeriut në Demokraci (QDNJD), raportuan se kanë asistuar gjatë veprimtarisë së tyre gra dhe vajza me aftësi të kufizuara viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, por nuk disponojnë statistika në lidhje me rastet e mbështetura.

AWEN, theksoi gjatë seancës dëgjimore se gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuar dhunohen nga familjarët ose kujdestarët e tyre dhe në mungesë të aksesueshmërisë ato nuk e kanë të mundur që të denoncojnë dhe janë të detyruara të jetojnë me dhunuesit e tyre. Ligji për



përfshirjen dhe aksesueshmërinë dhe ligji për shërbimet e kujdesit shoqëror nuk zbatohen për këtë kategori. Bashkitë por edhe organizatat e shoqërisë civile nuk kanë kapacitetet e nevojshme për të mbajtur personat me aftësi të kufizuar dhe në këto kushte viktima dhe dhunuesi ngelen në një vend. Përjetimi i dhunës nga ana e familjarëve ose e komshinjve, por edhe dhunës seksuale nga gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuar, u raportua edhe nga organizata Në Dobi të Gruas Shqiptare.

QDNJD, raportoi se gjatë punës së tyre me rastet e dhunës me gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuar, kanë konstatuar se pengesat kryesore që ndikojnë në mosraportimin e dhunës prej tyre, lidhen me vështirësitë ekonomike, paragjykimet, mungesën e informacionit, mungesën e besimit tek institucionet, stigmën dhe turpin për të kërkuar ndihmë publikisht, mosnjohjen e të drejtave të tyre, mosnjohjen dhe mospranimin e dhunës, si dhe mungesa e shërbimeve për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuar.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH), raportoi se, në databazën e tyre rezultojnë 19 raste të ankesave që lidhen me dhunën në familje, megjithatë nuk është e mundur të identifikohet nëse këto raste kanë të bëjnë me viktima të dhunës në familje, që janë persona me aftësi të kufizuar.

Gjatë seancës dëgjimore, MSHMS, raportoi se, aftësia e kufizuar është një nga elementët që përfshihet në të gjitha politikat e kësaj ministrie. Në bazë të të dhënave të raportuara nga nëpunësit gjinor pranë njësive të vetëqeverisjes vendore në sistemin REVALB, rezulton se për vitin 2021 janë raportuar 7 raste të dhunës në familje ku viktimat kanë qenë gra me aftësi të kufizuar. Përfaqësuesja e MSHMS, u shpreh se nuk përjashtohet mundësia që të ketë nënraportim të rasteve të dhunës ndaj personave me aftësi të kufizuar, pasi jo të gjitha bashkitë janë korrekte në hedhjen e të dhënave në sistemin REVALB.

Sa më sipër rezulton se, Policia e Shtetit nuk mban statistika për rastet e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, ku viktima të dhunës janë personat me aftësi të kufizuar. Sistemi REVALB, i cili përmban indikatorë në lidhje me aftësinë e kufizuar të viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, nuk rezulton që të gjenerojë të dhëna të besueshme në lidhje me këto raste.

Disa organizata të shoqërisë civile që punojnë me viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, kanë filluar të mbajnë të dhëna për viktimat e dhunës që janë me aftësi të kufizuar, edhe pse numri i këryre organizatave është i vogël.

Nga kryqëzimi i të dhënave të cilat u arritën të administroheshin nga disa prej DVP-ve dhe organizatave të shoqërisë civile, vlerësohet se numri i rasteve të raportuara të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje nga personat me aftësi në sistemin REVALB nuk pasqyron situatën reale të rasteve të dhunës ndaj personave me aftësi të kufizuar. Në bazë të të dhënave

të administruara, mund të thuhet se ka një nënraportim të rasteve të dhunës ndaj personave me aftësi të kufizuar në raport me dhunën reale të përjetuar.

Përfundimisht, Komisioneri vlerëson se, mbajtja e statistikave nga ana e Policisë së Shtetit në lidhje me personat me aftësi të kufizuar që janë viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, do të shërbente për të vlerësuar zbatimin dhe për të monitoruar progresin dhe efektivitetin e masave të marra në mbrojtje të viktimave të dhunë.

- **Sigurimi i aksesueshmërisë në mjedise, informacion dhe komunikim, në lidhje me ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës, veçanërisht për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuar.**

DPPSH raportoi se, për sa i përket aksesit të personave me aftësi të kufizuar, Policia e Shtetit ka vlerësuar problematikën dhe në projektet e ndërtimit të objekteve të reja, në objektet e rikonstruara dhe në ndërhyrjet e herëpashershme me fondet e buxhetit të shtetit është mundësuar realizimi/pajisja me rampa për personat me aftësi të kufizuar. Pothuajse të gjitha objektet e strukturave të Policisë së Shtetit janë të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuar. Ka përjashtime kur në varësi të terrenit nuk është e mundur krijimi/pajisja me rampë. Në bazë të informacionit të vendosur në dispozicion nga DPPSH, në lidhje me 5 DVP në të cilat është shtrirë hetimi administrativ, situata paraqitet si më poshtë:

DVP Tiranë: Në të gjitha komisariatet e policisë, ku janë të akomoduar zyrat në shërbim të qytetarëve (ZSHQ), janë krijuar/pajisur me rampa.

DVP Shkodër: Komisariati i Policisë Shkodër, objekt i ri, në të cilin ofrohet shërbimi ZSHQ, është i pajisur me rampë. Komisariatet e tjera në varësi të DVP Shkodër, nuk janë të pajisur me rampë, por i plotësojnë kushtet për lëvizjen/komunikimin me lehtësi të personave me aftësi të kufizuar.

DVP Elbasan: Në Komisariatet e Policisë Elbasan dhe Librazhd, të në cilët ofrohet ZSHQ, janë të krijuar/pajisur me rampa. Në Komisariatet e Policisë Cërrik, Gramsh, Peqin, zyrat e shërbimit qytetar janë akomoduar në ambientet e kateve përdhese (rrafsh me tokën), duke mundësuar aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar.

DVP Korçë: Në Komisariatet e Policisë Korçë, Pogradec dhe Devoll, në të cilat ofrohet ZSHQ, janë krijuar/pajisur me rampa për aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar.

DVP Fier: Në të gjitha Komisariatet e DVP Fier, në të cilat ofrohet ZSHQ, janë të pajisur me rampa për aksesueshmërinë e PAK.

Policia e Shtetit, raporton se, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur (NJIM), ka konsoliduar ndërtimin dhe vënien në funksion të Njësive të

intervistimit të të Miturve, sipas standarteve bashkëkohore në çdo DVP, të cilat përdoren edhe në rastet e trajtimit të viktimave të dhunës në familje ose viktimat e trafikimit. DVP-të gjithashtu raportuan se NJIM-të, shërbenin dhe përdoshin edhe për trajtimin e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës në familje, që ishin persona me aftësi të kufizuar.

DVP Tiranë dhe DVP Elbasan, raportuan se për kategorinë e personave që kanë vështirësi në dëgjim, shikim apo komunikim verbal të kufizuar ose të pamundur, nuk ka akte apo formate specifike për ta. DVP Elbasan, raportoi gjithashtu se, mungon një listë zyrtare pranë DVP me interpretë të caktuar që mund tu vijnë në ndihmë personave me aftësi të kufizuar. Mungesa e interpretëve të gjuhës së shenjave për personat me aftësi të kufizuar që nuk dëgjojnë raportohet edhe nga DVP Tiranë.

KShH raportoi se, në kuadër të veprimtarisë së tij monitoruese për respektimin e lirive dhe të drejtave të qytetarëve të cilët shoqërohen, ndalohen apo arrestohen në flagrancë nga punonjësit e Policisë së Shtetit, ka konstatuar se në ambientet e brendshme të komisariateve ka kushte të vështira higjeno-sanitare, dhe jo të përshtatshme infrastrukturore sa i përket mungesës së ajrimit, mungesës së dritës natyrale, mungesës së sistemit të ngrohjes. Gjithashtu ka konstatuar se, mungon infrastruktura e përshtatshme mbështetëse, për pritjen dhe zhvillimin e veprimeve procedurale me viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, të cilët janë me aftësi të kufizuara. KShH vlerëson se mbetet sfiduese organizimi dhe sigurimi i interpretuesve të gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar, në komisarariatet e vendit sipas parashikimeve që bëneni 58 pika 1 gërma “c” i Kodit të Procedurës Penale.

Përtej informacionit në lidhje me rampat në hyrje të ndërtesave ku ofrohen shërbimet nga ana e DVP Korçë, Fier, Tiranë, Shkodër dhe Elbasan, nuk u raportuan informacion i plotë në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë në mjedise në lidhje me të gjitha pengesat infrastrukturore që mund të përballen viktimat e dhunës gjinore dhe dhunës në familje, që janë persona me aftësi të kufizuar; nuk u administrua informacion në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë në informacion dhe komunikim; nuk u administrua informacion i plotë nga të gjitha DVP-të për sigurimin e aksesueshmërisë për kategoritë e ndryshme të aftësisë së kufizuar, personat me aftësi të kufizuar në lëvizje, në shikim, në dëgjim apo me aftësi të kufizuara të intelektit (*ku përfshihen personat që kanë vështirësi në të lexuar dhe në të nxënë nëpërmjet gjuhës (disleksi), në të shkruar (disgrafi), personat me aftësi të kufizuara intelektuale /zhvillimi, personat me aftësi të kufizuara të shëndetit mendor, personat me aftësi të kufizuara të të folurit/të të shqiptuarit.*). Ndërsa sipas informacionit të vendosur në dispozicion nga DVP Tiranë dhe Elbasan, rezulton se mungon aksesueshmëria në informacion dhe komunikim për personat me aftësi të kufizuar në shikim, dëgjim apo me komunikim verbal të kufizuar ose të pamundur.

Sa më sipër, në DVP Tiranë, Shkodër, Elbasan, Korçë dhe Fier, nuk rezulton që të garantohet aksesueshmëria në mjedise, informacion dhe komunikim për personat me aftësi të kufizuara, sipas standardeve dhe kritereve teknike të përcaktuara në VKM Nr.1503, datë 19.11.2008 dhe VKM Nr.1074, datë 23.12.2015. Rezulton një kuptueshmëri jo e saktë e konceptit të aksesueshmërisë. Mungesa e aksesueshmërisë në ndërtesat ku ofrohen shërbimet për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje sipas standardeve dhe kritereve teknike të miratuara si dhe mungesa e aksesit në informacion dhe komunikim për personat me aftësi të kufizuar që janë viktimat të dhunës nund të çenojë aksesin në shërbimet e ofruara nga ana e Policisë së Shtetit. Meqënëse aksesueshmëria, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuar gëzojnë në baza të barabarta me të tjerët të drejtat dhe liritë. Komisioneri vlerëson se dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm në raport me viktimat e tjera të dhunës gjinore dhe dhunës në familje që nuk janë me aftësi të kufizuar.

- **Procedurat dhe/ose udhëzimet specifike për trajtimin e rasteve të dhunës ndaj personave me aftësi të kufizuar, në veçanti ndaj vajzave dhe grave me aftësi të kufizuar;**

Në bazë të informacionit të administruar, rezultoi se nuk ka të miratuara procedura/udhëzime specifike për trajtimin e rasteve të dhunës ndaj personave me aftësi të kufizuar, e në veçanti ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuar, nga ana e Policisë së Shtetit.

Rezulton se në bazë të ligjit nr.9669/2006, të ndryshuar, janë miratuar dhe kanë hyrë në fuqi dy udhëzimet e përbashkëta të Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr.866, datë 20.12.2018 “*Për miratimin e modelit dhe të procedurave të vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje*” dhe Nr.912, datë 27.12.2018 “*Për miratimin e modelit të procedurave dhe procedurave për Urdhrin për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme*”.

Në Udhëzimin e Përbashkët Nr.866, datë 20.12.2018, përcaktohen procedurat për kryerjen e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit si dhe modeli i këtij vlerësimi. Referuar modelit të Raportit për Vlerësimin e Riskut për Rastet e Dhunës në Familje, të miratuar sipas këtij akti, në faktorët e riskut që vlerësohen, është fakti nëse viktimat ka probleme shëndetësore.

Në Udhëzimin e Përbashkët Nr.912, datë 27.12.2018, përcaktohen procedurat që ndiqen nga struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit për nxjerrjen e “*Urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme*” si dhe modelin e UMPMM.

VKM Nr. 327, datë 2.06.2021, i cili rregullon procedurat standarde bazë të Mekanizmit të Kordinuar të Referimit, ku Policia e Shetit, së bashku me një sërë institucionesh të tjera përgjegjëse, kanë detyrime për menaxhimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në marrëdhëniet familjare, nuk parashikon në mënyrë të veçantë hapat që duhet të ndiqen gjatë trajtimit të rastit të dhunës në familje ku është i përfshirë një person me aftësi të kufizuar.

Nga konsultimi i përmbajtjes së këtyre akteve, ku janë të parashikuara hapat për menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, përfshirë edhe rastet emergjente, që nga identifikimi dhe raportimi i rastit, deri në mbylljen e tij, nuk ka parashikime të posaçme se si duhet të veprojnë punonjësit apo strukturat përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, për rastet kur viktimat është me aftësi të kufizuar.

DPPSH raportoi se, në Procedurat Standarte për Trajtimin e Rasteve të Dhunës në Familje, Kreu IV, pika 1/1, germa “b”, përcaktohet: “Për të garantuar mbrojtje ligjore, veçanërisht siguri, për anëtarët e familjeve që i nënshtrohen dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar”. Ndërsa, Kreu IV, pika 5/2, germa “g” përcakton: “Për rastet e ngjarjeve që kanë të bëjnë me dhunën në familje, në raportin e ngjarjes, në rubrikën për “Viktimën” dhe “Dëshmitarin”, në një hapësirë të tij plotësohet për të treguar se ngjarja është rast i dhunës në familje, duke qarkuar gjithashtu marrëdhënien ndërmjet palëve. Gjatë përpilimit të këtij formulari punonjësi i policicë, duhet të dokumentojë: g) nëse ka patur fëmijë, të moshuar apo persona me aftësi të kufizuar të pranishëm apo të lënduar gjatë incidentit”.

Në bazë të informacionit të administruar qoftë nga rezulton se, në mënyrë të veçantë problematika të theksuara ndeshen në rastet e viktimave të dhunës që janë persona me probleme të shëndetit mendor. AWEN deklaroi gjatë seancës dëgjimore se në shumë raste viktimat e dhunës që janë persona me aftësi të kufizuar kthehen më pas në të akuzuar dhe dhunues, ndërsa QDNJD, ngriti shqetësimin se personat me aftësi të kufizuar të shëndetit mendor nuk arrijnë të kuptojnë rëndësinë e UM apo UMM. Problematika të trajtimit të rasteve të viktimave të dhunës në familje që janë persona me aftësi të kufizuar të shëndetit mendor, raportohen edhe nga DVP Tiranë, e cila shprehet se gjatë marrjes së masave për shtrimin në spital psikiatrik të këtyre personave ka pengesa pasi nuk gjenden persona që të japin miratimin.

Pavarësisht se personat me aftësi të kufizuar, përjetojnë shumë prej të njëjtave forma të dhunës që përjetojnë viktimat e tjera të dhunës në familje, aftësia e kufizuar, bën që dhuna të ketë shkaqe dhe forma të veçanta, si dhe të rezultojë në pasoja të veçanta. Gjithashtu, kur

gjinia dhe aftësia e kufizuar ndërveprojnë, këto dy shkaqe rezultojnë në një rrezik jashtëzakonisht të lartë të dhunës ndaj vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara.

Pavarësisht parashikimeve që bëhen në Procedurat Standarte për Trajtimin e Rasteve të Dhunës në Familje, ku evidentohet nevoja për ti kushtuar vëmendje të veçantë personave me aftësi të kufizuar, gjatë hetimit të zhvilluar nuk u identifikuan procedura/udhëzime specifike se si duhet të trajtohen personat me aftësi të kufizuar dhe si duhet të veprojnë punonjësit e policisë në mënyrë që të garantojnë mbrojtje efektive ligjore për këta persona.

Sa më sipër rezulton se Policia e Shtetit nuk ka procedura/udhëzime specifike për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, kur viktimat është person me aftësi të kufizuar/grua ose vajzë me aftësi të kufizuar. Për shkak se viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje të cilët janë me aftësi të kufizuar nuk janë në kushte të njëjta me viktimat e tjera që nuk janë me aftësi të kufizuar, si pasojë e ndërveprimit të aftësisë së kufizuar dhe barrierave që ngre shoqëria, dështimi për ti adresuar ndryshe nevojat e personave me aftësi të kufizuar, mund ti vendosi këta të fundit në pozita të disfavorshme duke mos iu garantuar mbrojtje efektive në kuadër të mekanizmave të mbrojtjes që ofrohet nga kuadri ligjor në fuqi për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

## **PËRFUNDIME**

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”,* si dhe *“Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”* (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese).

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit

ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet<sup>8</sup>. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme<sup>9</sup>. GJEDNJ, shprehet se, ndalimi që rrjedh nga neni 14 do të krijojë detyrime pozitive për shtetet kontraktuese për të bërë dallimet e nevojshme ndërmjet personave ose grupeve, rrethanat e të cilëve janë në mënyrë të rëndësishme dhe domethënëse të ndryshme<sup>10</sup>. Për më tepër, GJEDNJ, shprehet se, neni 14 nuk e ndalon një shtet anëtar që t'i trajtojë grupet ndryshe për të korrigjuar "pabarazitë faktike" ndërmjet tyre; në të vërtetë, në rrethana të caktuara, dështimi në përpjekje për të korrigjuar pabarazinë nëpërmjet trajtimit të ndryshëm, mund të shkaktojë në vetvete një shkelje të nenit 14<sup>11</sup>.

Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në Komentin e Përgjithshëm Nr.6 (2018) mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, shprehet, barazia formale synon të luftojë diskriminimin e drejtpërdrejtë duke i trajtuar në mënyrë të ngjashme personat në një situatë të ngjashme. Kjo gjë mund të ndihmojë në luftimin e stereotipeve dhe paragjytimeve negative, por nuk mund të ofrojë zgjidhje për "dilemën e dallimit", pasi nuk merr parasysh dhe nuk përqafton dallimet midis qenieve njerëzore. Në të kundërt, barazia thelbësore/substanciale kërkon të trajtojë diskriminimin strukturor dhe indirekt dhe merr parasysh marrëdhëniet e pushtetit. Ai pranon se "dilema e dallimit" përfshin si injorimin.

Pavarësisht numrit të lartë, personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të mbeten të padukshëm dhe të përjashtuar në shoqëri. Ky fakt e rrit rrezikun që ata të jenë viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Përjashtojë rinjtë, gratë shfaqin incidencë më të lartë të aftësisë së kufizuar. Të dhënat në lidhje me dhunën me bazë gjinore kundër grave me aftësi të kufizuar janë të kufizuara, çka në vetvete flet për një krizë të padukshme dhe sugjeron për një risk të shtuar për gratë me aftësi të kufizuar.

Për personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, procesi i raportimit të dhunës është shpesh i paarritshëm për shkak të politikave dhe standardeve jo të përshtatshme, qëndrimeve negative, përjashtimit, izolimit apo diskriminimit, mungesës së

---

<sup>8</sup> Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

<sup>9</sup> Shih: Çështja *Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

<sup>10</sup> Shih: Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

<sup>11</sup> Shih: Çështjen *Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë*, nr. 11146/11, datë 29.01.2013, prg. 101; Çështjen *Thlimmenos*, cituar më lart, prg. 44; Çështjen *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* (GC), nr.57325/00, GJEDNJ 2007-IV, prg.175).

aksesit fizik dhe atij të informacion. Dhuna ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara është një çështje komplekse dhe shumëdimensionale që lidhet me diskriminimin për shkak të gjinisë dhe aftësisë së së kufizuar. Të kombinuar, këto dy shkaqe, rezultojnë në një rrezik jashtëzakonisht të lartë të dhunës kundër vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuara.

Në këtë kuadër, aksesit në procedurat policore dhe ushtrimi i të drejtave dhe detyrimeve nga personat me aftësi të kufizuar, e në mënyrë të veçantë nga ana e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, viktima të dhunës në familje, në fushën e policisë, kërkon heqjen e të gjitha barrierave/pengesave dhe sigurimin e aksesueshmërisë, duke përfshirë përshtatjen e arsyeshme. Përshtatja e arsyeshme mund të përdoret si një mjet për të siguruar akses për një person me aftësi të kufizuara në një situatë të caktuar dhe për të eliminuar diskriminim *de facto*. Një shërbim policor gjithëpërfshirës cilësor për personat me aftësi të kufizuara, viktima të dhunës në familje, kërkon zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e një sërë standardesh, procedurash dhe udhëzimesh specifike.

Në Komentin e Përgjithshëm Nr.6 (2018) mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, në interpretimin që Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, i bën nenit 5, të Konventës, shprehet se: *“Barazia dhe mosdiskriminimi janë parime dhe të drejta. Konventa u referohet atyre në nenin 3 si parime dhe në nenin 5 si të drejta. Ato janë gjithashtu një mjet interpretues për të gjitha parimet dhe të drejtat e tjera të mishëruara në Konventë. Parimet/e drejta për barazi dhe mosdiskriminim janë gur themeli i mbrojtjes ndërkombëtare të garantuar nga Konventa. Promovimi i barazisë dhe trajtimi i diskriminimit janë detyrime ndërsektoriale të realizimit të menjëhershëm. Ato nuk i nënshtrohen realizimit progresiv.”*

Sa më sipër, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me qëllim parandalimin dhe rregullimin e sjelljeve dhe situatave diskriminuese si dhe bazuar në kompetencat që ligji Nr. 10 221 datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, i ka dhënë këtij institucioni, sikurëse përcaktohet në nenin 32, pika 1, germa “ë”, ku përcaktohet se: *“Komisioneri ka kompetencë: .....f)..... të bëjë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin”*,

## REKOMANDON

1. Marrjen e masave nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për të mbajtur statistika zyrtare në lidhje me rastet e dhunës në marrëdhënie familjare dhe dhunës me bazë gjinore të disagreguara sipas aftësisë së kufizuar.
2. Marrjen e masave nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për të miratuar dhe zbatuar procedura/udhëzime të posaçme për trajtimin e rasteve të dhunës në familje apo dhunës me bazë gjinore, kur janë të përfshirë personat me aftësi të kufizuar.



3. Marrjen e masave nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për të eliminuar gradualisht dhe në mënyrë sistematike pengesat/barrierat e të gjitha llojeve, për të aksesuar ndërtesat dhe shërbimet e ofruara, nga personat me aftësi të kufizuar viktime të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, me qëllim që të sigurohet aksesueshmëria e plotë.
4. Marrjen e masave nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe të gjitha strukturat e saj vendore, për të siguruar përshtatjen e arsyeshme për të gjithë personat me aftësi të kufizuar, që janë viktime të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.
5. Marrjen e masave nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për trajnimin e punonjësve të policisë në lidhje me trajtimin e rasteve të dhunës në familje ndaj personave me aftësi të kufizuar.
6. Marrjen e masave nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, jo vetëm në cilësinë e autoritetit kryesor përgjegjës për masat kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje por edhe të institucionit përgjegjës që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, për të bashkëpunuar me Drejtorinë e Përgjithshme të policisë së Shtetit, në lidhje me:
  - Harmonizimin e statistikave për rastet e dhunës në familje ndaj personave me aftësi të kufizuar;
  - Hartimin e procedurave, standardeve ose protokolleve, lidhur me trajtimin e rasteve të dhunës në familje ndaj personave me aftësi të kufizuar;
  - Organizimin e trajnimeve për parandalimin dhe trajtimin e çështjeve të dhunës në familje ndaj personave me aftësi të kufizuar për punonjësit e policisë;
7. Të gjitha masat e mësipërme, duhet të adresohen duke mbajtur në konsideratë rrezikun e shtuar të dhunës për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuar, të shkaktuar si pasojë e ndërveprimit të diskriminimit gjinor dhe aftësisë së kufizuar.
8. Të gjitha masat e mësipërme, duhet të adresohen duke mbajtur në konsideratë diversitetin e personave me aftësi të kufizuar dhe llojet e ndryshme të aftësisë së kufizuar.
9. Komisioneri nxit organizatat e shoqërisë civile që të bëjnë pjesë të protokollove të tyre:
  - Trajtimin e përshtatur për rastet e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje ndaj personave me aftësi të kufizuar;
  - Mbajtjen e statistikave të disagreguara sipas aftësisë së kufizuar, për rastet e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje të trajtuara nga ana e tyre.

Lutemi brenda 30 ditëve nga marrja dijëni, përcjelljen e informacionit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij rekomandimi apo çdo informacion tjetër që ka rëndësi lidhur me këtë çështje.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

**KOMISIONERI**

**ROBERT GAJDA**